

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**  
**PËR PROGRAMIN E STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË**  
**«PSIKOLOGJI KLINIKE»**  
**OFRUAR NGA ALBANIAN UNIVERSITY**

---

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**


**Prof.Assoc. Marjana Sinani**

**Dr. Anila Sulstarova**

**(Tetor/2018)**

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Uniersiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 597, dt. 28.05.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	UMASH Nr 327, dt 07.08.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i shkencave në "Psikologji klinike"
6	Cikli i studimit:	Cikli I dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	124 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve	54 studentë





## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Msc në «Psikologji klinike»

Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike në AU është hapur për herë të parë në vitin akademik 2011-2012. Programi është licencuar me VKM Nr. 597, dt. 28.05.2009, plotësuar me Urdhrin e MASH Nr. 308, dt. 08.06.2010. Programi është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 327, dt. 07.08.2012.

Programi ofrohet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme. Sipas përgjegjëses së Departamentit, programi është licensuar dhe është akredituar për herë të parë me 124 kredite. Aktualisht ofrohet po me 124 kredite.

Programi i studimit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të akreditimit të parë në vitin 2012. Programi akreditohet me UMASH Nr 327, datë 07.08.2012, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit nr 355, datë 13.07.2012. Sipas kësaj VKA për programin e studimit rekomandohet:

- Të përmirësohet ambjenti i bibliotekës
- Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi Bzën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Për plotësimin e këtyre rekomandimeve, GVJ është shprehur më poshtë në Raport.

Ecuria në vite e këtij programi paraqitet si më poshte:

- Në vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar për herë të parë në këtë program studimi 25 studentë, me notë mesatare në hyrje 7.1. Numri i pedagogëve të angazhuar është 16 pedagogë, dhe raporti PAE/PAK është 1/15;
- Në vitin akademik 2013-2014 u regjistruan në vit të parë 28 studentë, nga të cilët 27 janë regjistruan për herë të parë në vit të parë dhe 1 student i regjistruar me transferim në vit të parë. Nota mesatare në yrje e studentëve është 7.74. U angazhuan në mësimdhënie 14 pedagogë, në raportin PAE/PAK 5/9.
- Në vitin akademik 2014-2015 u regjistruan 25 studentë gjithsej, nga të cilët 17 studentë janë regjistruar për herë të parë në vit të parë dhe 8 studentë janë regjistruar me transferim në vit të dytë. Nota mesatare në hyrje e studentëve është 7.15. U angazhuan 9 pedagogë për të dhënë mësim në këtë program në raportin PAE/PAK 5/4.
- Në vitin akademik 2015-2016 u regjistruan 38 studentë në vit të parë, për herë të parë me notë mesatare në hyrje 7.52 dhe dhanë mësim 10 pedagogë në raportin PAE/PAK 4/6.
- Në vitin akademik 2016-2017 u regjistruan në total 31 studentë, nga të cilët 24 studentë janë regjistruar për herë të parë në vit të parë, 6 studentë janë regjistruar me transferim në vit të dytë dhe 1 student i regjistruar në vit të parë si program i dytë studimi. Nota mesatare në hyrje është 7.9 Janë angazhuar në mësimdhënie 11 pedagogë në raportin PAE/PAK 2/9.
- Në këtë vit akademik 2017-2018, u regjistruan 30 studentë, nga të cilët 23 studentë janë regjistruar për herë të parë në vit të parë, 6 studentë janë regjistruar me transferim, ku 1 student është regjistruar në vit të parë dhe 5 studentë janë regjistruar në vit të dytë dhe 1 student është regjistruar në vit të parë si program i dytë studimi. Nota mesatare në hyrje është 7.38. Në këtë vit janë angazhuar dhe kanë dhënë mësim 9 pedagogë në raportin PAE/PAK 3/6.

Vizita e planifikuar në «Albanian University» për programin e studimit Master i shkencave në «Psikologji klinike» u zhvillua në datat 01 dhe 02 shtator 2018. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u asistua dhe u shoqërua gjatë ditëve të vizitës nga Specialistet e ASCAL, Znj. Suela Kromidha dhe Znj. Avjola Bardhi. Në të dy datat respektive, u përmbushën objektivat e vizitës konform procedurave të miratuara për akreditim. Vizitat në mjediset fizike, takimet e punës u përmbushën sipas agjendës së paracaktuar. Vizita në Institucion u përmbush konform një protokollit të përcaktuar dhe të miratuar si nga GVJ ashtu edhe nga AU.

Qëllimet dhe procedurat e GVJ, u bënë me dije në praninë e strukturave të Institucionit nga ora në orë. Përgjatë vizitës, gjetëm mirëkuptimin dhe ishim mjaftueshmërisht të hapur {të dyja palët}, në funksion të së mirës së



përbashkët që e synojnë të dy institucionet respektive dhe që është "cilësia" dhe "standardi" në proces deri në përmbydhje të programit.

Konstatohet që: stafi akademik edhe personeli, përfshirë të gjitha nivelet dhe strukturat që nga institucioni i përgjegjës të departamentit, përgjegjës të zyrës së personelit, stafit akademik të brendshëm/të jashtëm, zhvillimit të kurrikulave, përfaqësues të studentëve, përcollën përgjegjëshmëri institucionale, kopetencë, etikë dhe vënë në dispozicion dokumentet e kërkuara nga GVJ.

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof.Assoc. Marjana Sinani
2. Dr. Anila Sulstarova

Menaxhere teknike e ASCAL për këtë program studimi është Znj Suela Kromidha.

Me datë 30.10.2018 dërgohet në Institucion nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 02.11.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe arsyetimi i GVJ në lidhje me disa nga këto objeksione është si vijon:

- Përsa i takon praktikave profesionale dhe marrëveshjeve mbi të cilat përbushen kjo pjesë e programit, GVJ, nuk pa asnjë dokument, marrëveshje, apo edhe draft marrëveshje me Institucionet specifike ku pritet që studentët të zhvillojnë praktikat profesionale, dimension substancial i programit të studimit.
- Në lidhje me zhvillimin profesional të stafit dhe mbështetjen e tij nga ana financiare nga AU, GVJ konstatoi se mbështetja financiare për zhvillimin profesional të stafit është minimaliste. Mbështetja që AU ju ofron pedagogëve si në botimet në revistën shkencore Optime, ashtu edhe në tarifën e reduktuar në prezantimin e kërkimeve shkencore në konferencat e zhvilluara nga Institucioni, janë detyrime të paevitueshme që Institucioni duhet ti ofrojë stafit.

Pikat e tjera në lidhje me numrin e studentëve dhe tarifën e shkollimit, u morën në konsideratë nga GVJ dhe u bënë ndryshimet përkatëse në Raport. Ndërsa në lidhje me përgjigjen e AU për bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe të specifikuar të studentëve dhe praktikave profesionale të tyre, GVJ vazhdon të mbajë të njëjtin qëndrim.

## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Në bazë të vendimit Nr. 355, datë 13.07.2012, Këshilli i Akreditimit, për Programin MSc. në Psikologji Klinike rekomandon:

- a) Të përmirësohet ambienti i bibliotekës.
- b) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni


- a) Për rekomandimin "Të përmirësohet ambienti i bibliotekës", GVJ gjatë vizitës në Institucion konstaton se: Institucioni ka një sallë bibliotekë. Konstatohet gjithashtu se ka shtim modest të titujve që nga akreditimi i parë. Mjedisi, është relativisht i përshtatshëm për të plotësuar nevojat e studentëve gjatë procesit të rritjes së tyre akademike. Koleksioni i librave përmban manuale, artikuj simpoziumesh, fjalorë, si dhe artikuj të ndryshëm gazetash të Universitetit. Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online si Questia, ERIC.

Rekomandimi është përbushur, referuar sygjerimit të më parshëm për të ri-pasuruar bibliotekën në tituj të tjerë dhe mundësi për të përvetësuar programin në respekt dhe konform literaturës së domosdoshme.



- b) Për rekomandimin “Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare”, institucioni në përputhje me ligjin nr 80/2015 si dhe në zbatim të Udhëzimit 52, datë 03.12.2015, (ndryshuar me Udhëzimin nr.11, datë 30.6.2016) “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, studentët e pranuar në këtë program studimi duhet të kenë njohje të gjuhës së huaj ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1, të certifikuar me një nga testet e njohura ndërkombëtarisht dhe të akredituara nga MASR në vendin tonë, përpara se të regjistrohen në këtë program studimi.

**Rekomandimi është përmbushur, referuar procesit të kontrollit gjatë vizitës në Institucion. Nuk konstatuam të kishte studentë që nuk dispononin dëshminë e gjuhës së huaj në njërën nga nivelet B.1 dhe C1.**





## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

Programi studimit Msc në "Psikologji klinike" u adresohet të diplomuarve që zotërojnë diplomën "Bachelor" në Psikologji, me njohuri, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim psikologjik.

Mbështetur në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB), por edhe gjatë takimeve në AU, GVJ kontaton se: Programi i studimit MSc "Psikologji Klinike" synon të diplomojë profesionistë kompetentë dhe të përgjegjshëm që zotërojnë njohuri të thelluara dhe shkathtësi profesionale në fushën e psikologjisë klinike, si dhe janë njohës dhe aplikues kompetentë të metodologjive të kërkimit shkencor në kontekstin klinik. Gjithashtu, synon që të krijojë themele të qëndrueshme njohurish në drejtim të kërkimit shkencor, duke mundësuar përgatitjen e profesionistëve të rinj për të vazhduar ciklet e mëtejshme të studimit, si dhe mundësinë për të qenë aplikues të metodave kërkimore shkencore.

Strategjitë afatshkurtra synojnë të realizojë planin e rritjes së kapacitetit të stafit akademik dhe të rritjes të cilësisë së mësimdhënies dhe kualifikimit të studentit në aspektin teoriko-praktik në mënyrë që të nxjerrim profesionistë të aftë si dhe t'i përgjigjen me sukses të gjitha detyrave që u ngarkon pozicioni i punës si psikolog.

Strategjitë afatmesme synojnë që në një periudhë kohore 3-5 vjeçare departamenti të ketë ngritur strukturat e duhura (koordinatorët, grupet e punës) për t'u përgjigjur më së miri nevojave të tregut të punës përsa i përket asaj që mund të japë për nxjerrjen e profesionistëve të kualifikuar dhe të aftë të shpalosin dijet e tyre në terren.

Strategjitë afatgjata shtrihen në një periudhë 7-10 vjeçare dhe synojnë rritjen e fuqizimin e njësisë bazë në nivel që t'i përgjigjet kërkesave të universiteteve perëndimore. Përmes këtyre strategjive synohet të investohet në infrastrukturën e njësisë përmes ndërveprimit gjithnjë e më të madh me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	GVJ konstaton se: Programi i studimit Master i Shkencave në "Psikologji Klinike" është hartuar në përputhje me misionin e Albanian University. Ky program studimi konsideron nevojat e tregut për përgatitjen e profesionistëve në fushën e psikologjisë klinike, synon që studentët të punësohen në institucione dhe organizata publike dhe private të cilat kanë karakter kërkimor dhe praktik. Studentët në përfundim të studimeve mund të punësohen pranë institucioneve të ndryshme kërkimore, të tilla si universitete, agjenci, organizata apo fondacione kërkimi, në pozicione si mësimdhënës, kërkues dhe ofrues të shërbimit, qendrat spitalore universitare, agjenci shtetërore dhe joqeveritare të shëndetit mendor, qendra të rehabilitimit, institucione riedukimi, gjykata dhe rajone policie, apo individualisht në sektorin privat (studio psikologjike).  Ky program ofron mundësinë që studentët të mund të ushtrorjnë praktikë private duke siguruar këshillim, terapi, vlerësim dhe konsultim ndaj individëve, familjeve, grupeve dhe organizatave.  Programi i studimeve është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, që kërkon një
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	



	orientim drejt shërbimeve psikologjike, sidomos në institucionet edukative, shëndetësore dhe në gjykata. Programi synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare, pasi i edukon dhe orienton studentët, krahas vlerave humane dhe me vlerat kulturore kombëtare.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivat e përgjithshëm pasqyrojnë parimet bazë mbi të cilat mbështetet AU.
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore përkatëse, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike.
<b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Emërtimi i Programit të Studimit është në përputhje me lëndët dhe çështjet që trajtohen gjatë programit. Ky program i përket nivelit 7 të Korniza Shqiptare e Kualifikimit.
<b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;	Albanian University ka hartuar dhe vendosur në zbatim “Strategjinë për Zhvillimin Institucional të Albanian University 2017-2022”.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Gjithashtu, GVJ Ju komunikua se Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme kanë planet strategjike të zhvillimit, të cilat përmbajnë, ndër të tjera, planet për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit dhe përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është hartuar në përputhje me misionin e Albanian University. Programi është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore përkatëse. Emërtimi i Programit të Studimit është në përputhje me qëllimin, objektivat dhe lëndët që trajtohen gjatë programit. Ky program i përket nivelit 7 të Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Mbështetur në RVB por edhe në takimin me Zv Rektoren e këtij Institucioni, e cila takoi GVJ në mungesë të Dekanit të Fakultetit të përgjegjës për këtë program studimi, shprehemi se: Fakulteti i Shkencave Shoqërore është njësi kryesore e Universitetit që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta apo të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Sipas Statutit të Universitetit, Fakulteti përbëhet nga autoritetet



drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë Dekani dhe përgjegjësit e departamenteve.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërje të tij katër departamente:

- Departamenti i Shkencave Politike-Administrative
- Departamenti i Shkencave Juridike
- Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Personeli Akademik përbëhet nga profesorë, lektorë dhe asistent-lektorë me kontratë me kohë të plotë, si dhe personeli akademik i ftuar, ku përfshihen profesorët dhe lektorët. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës. Sipas Statutit të AU, neni 33,36,38, personeli akademik ofron me cilësi një shërbim mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor sipas kërkesave dhe standardeve të IAL. Personeli akademik mund të angazhohet edhe me punë të tjera të natyrës administrative, në ndihmë të nevojave të Universitetit.

Në nivel njësie bazë raporti personal efektiv dhe me kontratë, për vitin akademik 2017-2018 është 10/18. Në nivel programi studimi Master i Shkencave në Psikologji Klinike raporti personel akademik efektiv dhe ai me kontratë është 3/6.

Njësia bazë në fillim të vitit akademik për lëndë/module që janë pjesë e kurrikulës së tij, por jo pjesë e disiplinës, mund të marrë pedagogë nga departamentet e tjera brenda fakultetit apo dhe jashtë tij, brenda universitetit. Për këtë program studimi ka pasur koordinime me njësi të tjera, kryesisht nga fusha e mjekësisë, dhe konkretisht lënda "Psikofarmakologji" mbulohet nga pedagogë të departamentit të Farmacisë.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Struktura organizative e Albanian University përmban nivelet hierarkike dhe njësitë e duhura përbërëse për të garantuar përmbushjen e misionit. Institucioni ka në përbërje të tij 3 fakultete që janë: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Secili prej fakulteteve ka në përbërje të tij 3 ose 4 njësi bazë.

Konkretisht: Fakulteti i Shkencave Shoqërore është i organizuar në 4 departamente: Departamenti i Shkencave Juridike; Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative; Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Stafi akademik i përfshirë në Masterin e shkencave "Psikologji klinike" ka formim në fushën e psikologjisë. Vetëm një anëtar i tij nuk vjen nga kjo fushë por ka përvojë të gjatë në mësimdhënie në fushën e pedagogjisë dhe edukimit. Pedagogët e këtij Masteri, si ata të brendshëm dhe ata të jashtëm janë me titullin Prof. As (2 pedagogë) dhe Dr (6 pedagogë), vetëm në një rast pedagogia është në proces doktorature, formimi i saj është jashtë shqipërie dhe është personalitet në fushën e psikoterapisë.

Mbështetur në të dhënat e paraqitura në RVB por edhe të verifikuara gjatë vizitës në Institucion, GVJ shprehet se për vitin akademik 2017-2018, Departamenti Psikologji e Përgjithshme ka në përbërje të tij 10 anëtarë PAE, nga të cilët: 1 pedagog me titull Prof.Asoc., 4 pedagogë me titull Doktor Shkencesh, 3 pedagogë në proces doktorature, dhe 2 pedagogë me Master shkencor. Si Personel Akdemik me kohë të pjesshme (PAK) ka 18 pedagogë prej të cilëve: 1 Prof.Asoc.Dr, 11 pedagogë me gradën Dr, 3 pedagogë me Dr në proces dhe 3 pedagogë me Msc.

Në vitin akademik 2016-2017 përbërja e Deartamentit ishte: 10 PAE (5 Dr; 3 Dr në proces; 2 msc) dhe 18 PAK (2 Prof Dr; 2 Prof. As; 7 Dr; 2 Phd; 2 Dr proces; 3 Msc)

Në vitin akademik 2015-2016, përbërja e Departamentit ishte: 13 PAE (1 Prof Dr; 1 Prof. As; 3 Dr; 5 Dr proces; 3 Msc) dhe 16 PAK (1 Prof Dr; 3 Prof. As; 6 Dr; 5 Dr proces; 1 Msc)



Në vitin akademik 2014-2015, përbërja e Departamentit ishte: 9 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof. As; 2 Dr; 5 Dr proces) dhe 20 PAK (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 4 Dr; 1 Specializim; 7 Dr proces; 4 Msc; 1 Ma)  
 Në vitin akademik 2013-2014, përbërja e Departamentit ishte: 20 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof. As; 1 Dr; 10 Dr proces; 7 Msc) dhe 31 PAK (1 Prof. Dr; 3 Prof. As; 8 Dr; 10 Dr proces; 9 Msc)  
 Ndërsa në vitin akademik 2012-2013 përbërja e Departamentit ishte: 8 PAE (7 Dr proces; 1 Msc) dhe 37 PAK (1 Prof. Dr; 1 Prof. Dr; 3 Dr; 11 Dr proces; 21 Msc)

Të dhënat më të detajuara për Departamentin dhe stafin e tij në vite, janë paraqitur ne Anekse, Tabela 1-2

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
**Dokumentacioni i marrë në institucion përkon me të dhënat e deklaruara në raportin e vetëvlerësimit të brendshëm**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p>	<p>Mbwshtetur nw RVB, Struktura organizative e Albanian University përmban nivelet hierarkike dhe njësitë e duhura përbërëse për të garantuar përmbushjen e misionit.</p> <p>Institucioni ka në përbërje të tij 3 fakultete që janë: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore është i organizuar në 4 departamente: Departamenti i Shkencave Juridike; Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative; Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka në përbërjen e vet 10 anëtarë si personel efektiv akademik, ku 1 pedagog ka gradën shkencore Prof. Asoc, 4 pedagogë kanë gradën shkencore "Doktor", 3 pedagogë janë Dr në proces dhe 2 prej tyre janë Msc</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e Departamentit të hyrë në fuqi menjëherë pas Vendimit të Senatit Akademik Nr 8 datë 28.02.2018, por edhe të Fakultetit, Përgjegjësitë e njërive bazë dhe kryesore janë të mirë përcaktuara në këtë Rregullore. Sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje: Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në AU, në zbatim të Ligjit-Nr 80/2015 (neni 25), Statutit të Institucionit (neni 16), Rregullores së Përgjithshme të Institucionit (neni 24) është njëzi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Ky Departament përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplina mësimore respektive.</p> <p>GVJ ju komunikua se nevoja për plotësim të vendeve vakante lind në Departament para fillimit të vitit akademik. Nisur nga vendet vakante, bëhet edhe kërkesa nga Departamenti i cili i përcillet Dekanit të Fakultetit. Më tej kjo kërkesë përcillet në Rektorat nga</p>



ku zyrat përkatëse bëjnë edhe njoftimet. Njoftimet për vende të lira pune vendosen në faqen e institucionit.

### Konkluzionet e vlerësimit:

AU organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për përmbushjen e misionit të tij  
Njësia bazë për të përmbushur objektivat e këtij programi studimi ka angazhuar burime njerëzore maksimale në përputhje me profilin e programit të studimit

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

GVJ konstaton se Stafit akademik i përfshirë në mësimdhënien e programit Msc "Psikologji klinike", për vitin akademik 2017-2018 është me kualifikimet e përshtatshme. Numri i pedagogëve të brendshëm të angazhuar në këtë program studimi është 3, ndërsa numri i pedagogëve me kontratë është 6. Në tabelën e paraqitur në RVB faqe 12, numri i personeli akademik të ftuar është 7, por në planin mësimor të lidhur me pedagogun përkatës, numri i personelit të anagazhuar është 6. Pedagogja A.Ç nuk ishte e angazhuar në procesin mësimor për këtë vit akademik edhe pse ishte parashikuar për të dhënë mësim në këtë program.  
Sipas të dhënave të deklaruara edhe në RVB ngarkesa e stafit të brendshëm është e lartë. Shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik nuk është e qartë se mbi ç'kriteret është bërë shpërndarja e orëve. Një pedagoge rezultoi me 195 orë në këtë Master, të tjerë edhe të brendshëm, rezultojnë me një numër ndjeshëm të reduktuar. Gjithashtu bazuar në kontratat e pedagogëve, të shikuara gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore, u vu re që një PAE ka një ngarkesë vjetore 1300 orë në një vit akademik (edhe në programet e tjera që ofron AU) dhe të tjerët me PAE në të njëjtin departament me më pak se 400 orë. Kjo ngarkesë, i përket të njëjtit pedagog që ka 195 orë në këtë Program studimi dhe gjithsej 1300 orë në vit në programet e tjera që ofrohen nga i njëjti Departament apo edhe të tjera, ndikon ndjeshëm në përgatitjen e pedagogut për lëndët që jep dhe për rrjedhojë prek cilësinë e mësimdhënies.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i personelit akademik të brendshëm në këtë program studimi është 3; Personeli akademik me kontratë është 6 dhe personel administrativ është 7.

Titulli	Stafit akademik për programin e studimit Master i Shkencave Psikologji Klinike Viti akademik 2017 -2018		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	0	0	0/0
Profesorë të As.	1	1	1/1
Dr./PhD	1	5	1/1
Pedagogë në proces Dr.	1	0	1/0
Asistentë me M.Sc	0	0	0/1
Personeli Administrativ	7	0	7/0

Pedagogët e angazhuar në vite në këtë program studimi, mbështetur në të dhënat e paraqitura nga Institucioni në Dosjen e Vetylerësimit, paraqiten si më poshtë:



**Stafi akademik i programit në vitin 2012-2013 – 1 PAE (1 Dr proces) dhe 15 PAK (1 Prof. Dr; 1 Prof Asc; 3 Dr; 4 Dr proces; 6 Msc)**

**Stafi akademik i programit në vitin 2013-2014 – 5 PAE (1 Dr; 2 Dr proces; 2 Msc) dhe 9 PAK (1 Prof Asc; 4 Dr; 3 Dr proces; 1 Msc)**

**Stafi akademik i programit në vitin 2014-2015 – 5 PAE (1 Prof. As; 2 Dr; 2 Dr proces) dhe 4 PAK (1 Prof Asc; 2 Dr; 1 Dr proces)**

**Stafi akademik i programit në vitin 2015-2016 – 4 PAE (1 Dr; 2 Dr proces; 1 Msc) dhe 6 PAK (1 Prof. Dr; 4 Dr; 1 Dr proces)**

**Stafi akademik i programit në vitin 2016-2017 – 2 PAE (1 Dr; 1 Dr proces) dhe 9 PAK (2 Prof Asc; 6 Dr; 1 Msc)**

**Stafi akademik në vite dhe përbërja e moshës është paraqitur në Aneks tabelë 4**

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Ky program studimi nuk ka Këshill Shkencor. Koordinator i programit është staf akademik efektiv, që nuk është i përfshirë në mësimdhënie për këtë program studimi. Koordinator është në proces të përfundimit të studimeve doktorale (Dr.Proc. Dritan Taulla)

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre  
Në këtë program studimi pjesa më e madhe e stafit akademik të përfshirë është me titullin shkencor Dr. Raporti është më dominues për PAK, duke qënë se ai zë dhe numrin më të madh të personelit akademik të angazhuar në këtë program si në këtë vit akademik por edhe në vite.

Të dhënat sipas seksit  
Përgjithësisht, raporti gjinor i personelit akademik të përfshirë në këtë program dominohet nga gjinia femërore.

Të dhëna sipas moshës së personelit  
Pjesa më e madhe e personelit akademik PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program studimi i përket grupmoshës 36-45 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat  
Gjatë vizitës në Zyrën e burimeve njerëzore u panë disa nga kontratat e punës së personelit akademik si me kohë të plotë ashtu edhe me kohë të pjesshme. Kontratat e punës përmbajnë detyrat dhe të drejtat e punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe në anekset bashkëlidhur tyre ngarkesa semestrale për personelin akademik.  
Për stafin e brendshëm, kontratat e punës ishin pa afat, ndërsa për pedagogët e jashtëm me titull Prof Dr; Prof As dhe Dr, kontrata e punës ishte me afat të pacaktuar.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë  
Stafi ndihmës/administrativë i përfshirë në këtë program studimi ndihmon në veprimtaritë e mësimdhënies.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
Sipas analizës së të dhënave e Dosjes së vetëvlerësimit, gjëndjen e konstatuar në Institucion gjatë vizitës krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (DVV) këta tregues nuk ndryshojnë.

Dokumentacioni i parë në institucion është koherent me RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve	
Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit	GVJ konstaton se AU ka angazhuar personel akademik, personel ndihmës akademik me karakter mësimor, që ndihmojnë në realizimin e veprimtarisë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe personel me karakter administrativ, që ndihmon në realizimin e veprimtarive



<p>angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>Në këtë program studimi janë angazhuar, 9 anëtarë si personel akademik dhe 7 anëtarë si personel ndihmës mësimor dhe administrativ.</p>
<p><b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Çdo titullar lënde rishikon syllabuset e lëndëve sipas planit mësimor dhe propozon ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e lëndës në aspektin e mësimdhënies dhe literaturës së sugjeruar.</p> <p>Departamenti ngrinte një grup të posaçëm pune për rishikimin e kurrikulave (pjesë e grupit janë edhe anëtarët e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti), anëtarë të cilët janë pedagogë efektivë dhe me kontratë, grup i cili bashkë me titullarët e lëndëve propozon ndryshimet përkatëse te Dekani.</p> <p>A.U. veprimtarinë e tij e realizon në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për rekrutimin e personelit të ri dhe shpërndarjen e ngarkesës tek të rinjtë.</p> <p>Rezultoi se një nga anëtarët e stafit të brendshëm, ka ngarkesë që tejkalon limitet e ngarkesës sipas ligjit për Arsmin e Lartë dhe mundësive fizike për një pedagog në Arsimin e lartë.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Nga takimi me Përgjegjësen e Departamentit, GVJ ju theksua se: Për rekrutimin e personelit të ri akademik Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme përdor procedura ligjore në përputhje me statutin, rregulloren dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. AU shpall njoftime për vende të lira pune, të cilat afishohen edhe në faqen zyrtare të IAL.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në programin e studimit Master i Shkencave Psikologji Klinike <b>nuk përbën 70%</b> të personelit akademik të angazhuar. Në këtë program janë angazhuar në këtë vit akademik 3 PAE dhe 6 PAK. Ngarkesa mësimore në numër të pedagogëve rezultoi 33% PAE dhe 67% PAK, ndërsa si ngarkesë në orë, referuar kjo edhe të dhënave të paraqitura nga vetë Institucioni në RVB faqe 12, rezultoi se ngarkesa në orë mësimore për PAE (gjithsej 405 orë) është 44% përkundëjt ngarkesë së PAK (gjithsej 510 orë) e cila është afërsisht 56%</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore si dhe krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik. Në Departamentin e Psikologjisë vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore të pedagogëve zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik, me</p>



	<p>mbështetjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe përfshin vlerësim të të gjithë aktorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi nga drejtuesit e departamenteve</li> <li>- Vlerësimi nga studentët</li> <li>- Vlerësimi nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë</li> </ul> <p>Të dhënat, materialet dhe i gjithë dokumnetacioni për raportet e rekrutimit të personelit, njoftimet për vende vakante, personel i ftuar akademik, ruheshin me kujdes dhe arkivoheshin nga Zyrat përkatëse të AU.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të ftuar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektor, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Koordinatori i programit është aktualisht me Msc dhe ndjek studimet Dr, pra është Dr në proces.</p> <p>Referuar syllabuseve të lëndëve rezulton se Titullarët e lëndëve në këtë program studimi kanë titujt “Profesor i Asociuar”. Vërehet se ka pedagogë që janë titullarë lëndë në më shumë se dy lëndë.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit është i punësuar me kohë të plotë në AU.</p> <p>Njësia bazë ka rishikuar kurrikulat në përshtatje të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe <u>në kurrikulën e re që do të implementohet prej vitit akademik 2018-2019 [Evidencë 3.7] është përfshirë praktika profesionale për këtë program studimi.</u></p> <p>Njësia bazë ka parashikuar një pedagog, i cili do të jetë përgjegjës për supervizimin e praktikave profesionale. Procedimi për praktikat profesionale nuk del qartë, nuk funksiononin mbi marërveshje specifike me institucione specifike. Në rastet që kontaktoam, studentët e kishin zgjidhur praktikën profesionale në mënyrë individuale.</p> <p>Praktikat dukeshin që ishin mbështetur më shumë në kontaktet personale të pedagogut dhe disa institucione që zyra e Karrierës dhe Alumnit ka.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Mbështetur në RVB por edhe gjatë verifikimit të disa prej dosjeve të studentëve, GVJ konstaton se: Studentët e regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji klinike” janë të profilit të psikologjisë.</p> <p>Studentët e ciklit të dytë të studimeve udhëhiqen nga momenti i përzgjedhjes së temës deri në prezantimin dhe mbrojtjen e saj përpara jurisë.</p> <p>Për të ndihmuar studentët në drejtim të punës kërkimore shkencore, departamenti kishte vënë në</p>



	<p>dispozicion të studentëve një Manual Udhëzues “Si të shkruajmë një temë diplome”.</p> <p>Stafi akademik përcaktohet nga departamenti për të udhëhequr studentët e ciklit të dytë të studimeve. Në përgatitjen e mikrotezës pedagogët kanë gradë shkencore “Doktor”, por ka edhe pedagogë udhëheqës që janë në proces doktorature dhe aktualisht janë me MSc. Në vitin akademik 2017-2018 u diplomuan 21 studentë, të cilët u udhëhoqën nga 5 pedagogë prej të cilëve 4 me gradë shkencore Dr. dhe 1 pedagog në Dr. Proces.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme respekton një raport të caktuar gjatë shpërndarjes të pedagogëve që do të udhëheqin studentët e ciklit të dytë të studimeve. Sipas të dhënave numri i studentëve që udhëheq një pedagog varion nga 4-6 studentë.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Pedagogët udhëheqin kërkime shkencore të cilat përputhen me fushën e tyre të ekspertizës, orientimin e tyre profesional dhe praktikën e punës.</p> <p>Udhëheqësi shkencor që angazhohet në mentorimin e një studenti në ciklin e dytë të studimeve përgjithësisht është profesionist i fushës dhe i familjarizuar me metodat e hulumtimit shkencor.</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në këtë program studimi nuk ka orë laboratorike dhe nuk ka në përdorim laboratorë. Ky program por edhe programet e tjera të ofruara nga ky departament nuk kanë parashikuar orë laboratorike as Detyra, për vetë specifikat e fushës.</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>GVJ konstatoi se: Institucioni nuk ka shpërndarje të drejtë dhe të justifikueshme të ngarkesës mësimore.</p> <p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar sipas shpërndarjes që bëhen nga njësia bazë. Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet duke u orientuar në dy drejtime: a-ngarkesë në mësimdhënie; b- ngarkesë për udhëheqje në tema diplomash.</p>
<p><b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e angazhimit në mësimdhënie si dhe ngarkesën që mbulon. Institucioni ruan informacionet lidhur me stafin akademik dhe personelin ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ngarkesën përkatëse.</p> <p>Për çdo semestër të vitit akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore në AU publikon, çdo vit në periudhën korrik</p>



– shtator, vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen e internetit, si dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Standartet për procedurat e rekrutimit të personelit akademik, janë ligjërisht korrekte. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në disa raste funksionon jo korrekt. (rasti i ngarkesës së një stafi të brendshëm me 1300 orë)

Procedimi për praktikat profesionale nuk del qartë, kjo pjesë e programit nuk funksiononin mbi marrëveshje specifike me institucione specifike. Në rastet që kontaktuam, studentet e kishin zgjidhur praktikën profesionale në mënyre individuale.

Praktikat profesionale janë ende territor i ri dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet janë ende në proces. Pra, jo për të gjithë studentët ka institucione për praktikë të mirëorientuar dhe të mentoruar.

Sugjerohet rishikimi i shpërndarjes së ngarkesës së pedagogëve dhe rikonceptimi i marrëveshjeve specifike me institucione specifike që garantojnë përmbushjen e praktikave mësimore

Sugjerohet të përfshihet më shumë staf i brendshëm {me formim të thelluar në disiplinat e psikologjisë klinike} kusht, për të përmbushur kriteret për të qenë pjesë e mësimdhënies në këtë master shkencor.

Sugjerohet që në këtë program të përfshihen dhe pedagogë të tjerë të kualifikuar për të dhënë mësim në këtë master në mënyrë që edhe të vendoset një balancë në shpërndarjen e lëndëve.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Referuar RVB por edhe vizitës në vend, GVJ shprehet se:

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme e zhvillon procesin akademik në godinën qendrore e cila ndodhet në Bulevardin “Zogu I”, me një sipërfaqe prej 3996 m<sup>2</sup>. Ndërtesa ka qenë ekzistuese dhe të gjitha ambientet e saj janë rikonstruktuar sipas kushteve bashkëkohore të adoptuara në klasa dhe laboratorë për zhvillimin e aktivitetit të edukimit duke plotësuar kërkesat e secilit departament për të ofruar çdo program studimi.

Të gjitha auditorët janë të pajisura me video projektor dhe tryeza pune komode e të organizuara. Sallat dhe zyrat kanë të instaluar sistem kondicionimi ngrohje-ftohje, janë të pajisura me kompjuter, video projektor, ekrane të mëdha, flipcharte.

Rrjeti i kompjuterik që përdoret nga studentët, stafi akademik dhe punonjësit e administratës është i lidhur dhe ka shërbim interneti pa limit në të katër godinat e Albanian University. Universiteti ka ëëbsite-in e tij zyrtar (<http://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/>).

Salla e bibliotekës disponon një numër tavolinash dhe kënd leximi, me një hapësirë që plotëson kërkesat e studentëve. Shërbimi bibliotekar realizohet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga institucioni dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët.

Institucioni çdo vit planifikon fond të veçantë për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi dhe në mbështetje të kërkimit shkencor. Fondi i bibliotekës pasurohet çdo fillim viti me literaturën e përshtatshme të bazuar në kërkesat e gjeneruara nga departamenti në fund të vitit paraardhës. Deri tani në fondin e bibliotekës numërohen rreth 23 tituj që i përkasin fushës së studimit. Institucioni shpenzon çdo vit rreth 30,000 Lekë fonde të planifikuara për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi dhe në fushën e kërkimit shkencor. Biblioteka e godinës ku zhvillon mësim programi punon nga ora 8.00 deri në orën 16.00. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj. Literatura bazë e përdorur nga pedagogët është kryesisht ajo që përdoret në universitetet e tjera publike në gjuhën shqipe.



Biblioteka online QUESTIA është një tjetër veçori e infrastrukturës universitare. "QUESTIA" funksionon gjatë 24 orëve, përmban 83,000 libra akademikë dhe mbi 10 milionë artikuj shkencorë, të cilat janë në dispozicion për t'u aksesuar pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik për mbështetjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.

Libraria e Universitetit ndodhet në godinën me adresë "Rruga e Durrësit".

OPTIME - është revista shkencore e AU në të cilën botohen të gjithë punimet shkencore në kuadër të përmbushjes së kërkesave për kërkime dhe punime shkencore në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve.

Albanian University Press - është ndërmarrja botuese pjesë e "Albanian University", nga e cila janë botuar të gjithë librat në kuadër të përmbushjes së kërkesave për tekste mësimore dhe shkencore në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve. Kjo ndërmarrje botuese regjistron në listën e saj një volum të konsiderueshëm botimesh, siç janë librat, tekstet mësimore, tituj e rëndësishëm studimorë, akademikë dhe shkencorë. Shërbimi i fotokopjes që ndodhet në librarinë e universitetit mund të përdoret nga studentët dhe pedagogët.

Salla e Konferencave - është ambienti i pajisur me multimediale, audio dhe video, për realizimin e konferencave të koordinuara me sistemin e qendrës së zërit dhe qendrën e përkthimit simultan që përdoret për ushtrimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare, siç janë simpoziumet, konferencat, seminarat, leksionet e hapura shkencore.

Laboratori i Informatikës - është në funksion të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Përgjatë zhvillimit të orëve mësimore në këto ambiente është i pranishëm gjithmonë një punonjës i IT.

Mjedise si kafeteri/fast-food - është në funksion edhe lokali i vetëshërbimit ushqimor për të gjithë studentët e AU në këtë ndërtesë.

Shërbimi i sigurisë - ndërtesat janë të pajisura me sistem kamerash vëzhguese në të gjitha hollet e kateve si dhe në mjediset e jashtme, të cilat janë të monitoruara gjatë 24 orëve me roje private të cilët shërbejnë në ruajtjen dhe sigurinë e ambienteve.

Zyra e informacionit dhe recepsionit - mundëson shërbim për çdo informacion që kërkohet si nga ana e studentëve ashtu dhe nga persona të tjerë të interesuar lidhur me programet mësimore.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione 10	10	1,120.2
Klasa për seminare 20	20	1,005
Salla për aktivitete promovuese 1	1	245
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	0	0
Laboratorë informatike 1 35	1	35
Salla interneti 0 0	0	0
Salla për bibliotekë 1	1	248.6
Mjedis për fotokopjime, librari etj 1 7	1	7
Zyrë informacioni për studentët 1 6	1	6
Korridore/holle 11+ 645	11	+645
Mjedise sportive 0 0	0	0
Mjedise shërbimi për të tretë 2 567	2	567



Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore 1 16	1	16
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj 2 567	2	567
Nyje hidrosanitare për studentët 6 106.4	6	106.4
<b>Norma m<sup>2</sup>/për student</b>	<b>4618.2 m<sup>2</sup>/652 studentë = 7.08 m<sup>2</sup> për student</b>	

Mjediset për stafin:

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja m <sup>2</sup>
Zyra për Dekanin	1	9
Zyra për Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme	1	20.3
Zyra për sekretarinë mësimore	2	40
Zyra për personelin akademik të departamentit		
Zyrë për financën	2	47
Zyrë për Njësinë e SBC dhe Zyra e Kurrikulave	1	23.2
Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve	1	14.8
Zyrë për IT	1	20
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	2	6.4
<b>Norma m<sup>2</sup>/për person</b>		

Sipas dosjes së vetëvlerësimit dhe asaj që u konstatua në vizitën dyditore në AU vëmë re që nuk ka ndryshime sipas asaj që është në RVB. Institucioni përbush standartet fizike.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
**Dokumentacioni i parë në IAL AU përkon me RVB**

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Godina e AU gjëndet pranë sheshit Skënderbej.
<b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Institucioni ka katër godina të ndara sipas fakulteteve përkatëse. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme e zhvillon procesin e tij mësimor vetëm në mjediset e godinës qendrore të AU, me një sipërfaqe totale prej 3996 m <sup>2</sup> .
<b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	AU i disponon këto mjedise me kontrata të përsëritura prej vitit 2006.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Institucioni garanton mjedise të përshtatshme e të mjaftueshme për realizimin e programeve të studimit



**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Literatura e paraqitur në çdo syllabus të programeve mësimore dhe e sugjeruar nga personeli akademik përbëhet nga botime që përdoren në universitetet publike në gjuhën shqipe. Një pjesë e këtyre teksteve janë edhe me autorësi të pedagogëve të AU.

Në bibliotekë gjenden 23 tituj në ndihmë të programeve të ofruara nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme.

Libraria elektronike "QUESTIA", me rreth 83,000 tituj, është në funksion të programit.

Biblioteka punon gjatë orarit 08.00-16:00. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit, dhe me orarin e shërbimeve ekstra, në oraret mësimore të studentëve për sezona të veçanta.

Cdo student mundësohet të ketë kartelë regjistrimi.

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme për mësimdhënie, me hapësira, salla konferencash të pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të mëdha, flipcharte, multimedia.

Ambientet kanë tryeza punë që stimulojnë veprimtari bashkëbiseduese ku vendosen në formën e një rrethi për të nxitur ndërveprimin.

Laboratori i informatikës ka kapacitet për 30 persona.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme për mësimdhënie, Laboratori i Informatikës - është në funksion të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Institucioni ka katër godina të ndara sipas fakulteteve respektive. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme e zhvillon procesin e tij mësimor vetëm në mjediset e godinës qendrore të AU. Programi në fjale garantohet të përmbushë qëllimin dhe objektiva, referuar mjedisve mësimore. Literatura e paraqitur në çdo syllabus, e sugjeruar nga stafi akademik i referohet botimeve që përdoren në universitetet publike në gjuhën shqipe

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**Piesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sipas RVB, takimeve të GVJ gjatë vizitës në vend, këtij Grupi ju komunikua se Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare të përmendura në tabelën me poshtë. Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare dhe kontrollin e tyre .

Institucioni ka një raport financiar për cdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj..

Studentët paguajnë vetëm tarifën e programit të studimit, nuk ka pagesë ekstra për aplikimin fillestar dhe regjistrimin përveç tarifës së studimeve.



Burimet financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve. Rreth 1/3 e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohet për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja, etj.).

Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Të ardhurat nga:	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6
Pushteti qendror	-	-	-	-	-	-
Pushteti vendor	-	-	-	-	-	-
Fonde jopublike:	-	-	-	-	-	-
Grantet për kërkim dhe kontratat	-	-	-	-	-	-
Konsulencat, shërbimet	-	-	-	-	-	-
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	14'910' 000	11'130 '000	19'530 '000	15'997 '500	13'972 '500	10'530 '000
Sponsorizimet	-	-	-	-	-	-
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	-	-	-	-	-	-
Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj.	-	-	-	-	-	-
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj.)	100'000	20'000	10'000	56'000	240'00 0	170'00 0
<b>SHUMA</b>	<b>15'010' 000</b>	<b>11'150 '000</b>	<b>19'540 '000</b>	<b>16'053 '500</b>	<b>14'212 '500</b>	<b>10'700 '000</b>

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik

Shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondin e ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Kostoja për një student në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike është 900 euro për vit akademik. Tarifa vjetore është 1500 euro.

Dokumentacioni i parë dhe marrë në IAL AU është në koherencë me me RVB.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	



<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficientësinë e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Mbështetur në RVB por edhe gjatë takimeve me Përgj e Departamentit dhe me Zyra të tjera, me përfaqësuesit e të cilave GVJ bisedoi rreth burimeve financiare, GVJ shprehet se: Institucioni kryen audit të përvitshëm për situatën financiare. Raporti i auditit përmban pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet; theksojmë se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.</p> <p>Raportet e auditit analizojnë eficientësinë e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve të ciklit të parë të studimeve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni ka raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Raporti financiar, garanton qëndrueshmërinë e programit.</p> <p>Institucioni harton bilancin financiar, i cili përmban pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontribute të tjera financiare.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>Institucioni ka raport financiar të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Për të rritur të ardhurat e IAL, AU sugjerohet më shumë politika strategjike adresuar institucioneve potenciale ku pritet të punësohen të diplomuarit në këtë program. Fokusi i institucionit drejtuar donatorëve të tjere që kryejnë shërbime të ngjashme dhe paraqesin interesa në të ardhmen nuk na konfirmohet gjatë vizitës.</p> <p>Institucioni spjegon në tabela financiare dhe shpenzimet specifikisht për çfarë shkojnë. Referuar RVB, citojmë që kostoja për një student në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike është 900 euro për vit akademik.</p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ kishte të parashikuar në agjendën e tij edhe takimin me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Mbështetur edhe në RVB por edhe gjatë bisedës me kryetaren e kësaj zyre, konstatohet se: Në Albanian University, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2009 -2010. Që nga ajo kohë, Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe së fundmi në përputhje me ligjin 80/15 me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional, i cila harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë, shprehur edhe në Statutin e AU.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka akses në të gjitha informacionet e Universitetit, duke mundur në bazë të politikave dhe kriterëve që kjo njësi mendon të përshtatshme, sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe ka për detyrë paraqitjen e një raporti vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Raporti pasi paraqitet në Senat Akademik, miratohet dhe publikohet në faqen zyrtare ëeb.



Gjithashtu, funksionet dhe detyrat e NjsBC, janë të parashikuara shprehimisht në nenin 14 të Rregullores së brendshme të Universitetit si dhe në Rregulloret specifike për sistemin e Sigurimit të Cilësisë. NjsBC ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrativë me strukturat e tjera akademike dhe administrative të Universitetit, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

NjsBC funksionon edhe në nivel njësie bazë që në shtator të vitit 2016 me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë brenda saj, me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016. Kështu, në nivel njësie bazë, në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, fokus – grupeve, raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njësisë bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të NjsBC nga njësia bazë dhe sekretaria mësimore. NjsBC analizon të dhënat dhe nxjerr në pah çështjet dhe situatat për përmirësim, me qëllim rritjen e performancës së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, ndërveprimit të të gjithë faktorëve përbërës së Universitetit (Evidenë 6.2).

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
  - Çdo vit akademik realizohen 2 anketime, një në çdo fund semestri akademik.
  - Rreth 35% e studentëve të regjistruar në Programin e studimit kanë marrë pjesë në anketim në vitin akademik 2017-2018.
  - Të gjithë pyetësorët e plotësuar janë përpunuar, me metoda cilësore dhe sasiore, në varësi të llojit të pyetjes.
  - Disa nga problematikat e përmendura nga studentët, kanë të bëjnë me problematika në infrastrukturë, angazhimi i pedagogëve të ndryshëm për leksione dhe seminare, etj

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Në Albanian University, Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga sistemi i sigurimit të cilësisë. Ky sistem përbëhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila siguron drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit si dhe nga Komisioni për Vlerësim Institucional, i cili është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në AU, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet për Sigurimin e Cilësisë në HEAL.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti  
NjsBC për ruajtjen, nxitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bashkëpunon me njësitë bazë nëpërmjet Grupeve të Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel departamenti.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton një raport semestral dhe një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkuese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësim në të ardhmen.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Referuar vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional me QAA, NjsBC ka marrë vlerësime pozitive, duke e cilësuar si praktikë të mirë ngritjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti me qëllim monitorimin më të detajuar të parametrave të cilësisë.

Analiza e dosjes së vetëvlerësimit është koherente me atë që u vu re në IAL AU.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Në fund të çdo semestri njësia bazë dorëzon raportin semestral, në të cilin përveç të tjerave, pasqyrohen rezultatet e studentëve (kalueshmëria) dhe rezultatet e anketave me studentët. Në përfundim bëhet një analizë krahasimore për ndryshimet dhe ecurinë e të dhënave të shqyrtuara.</p> <p>Institucioni në përfundim të çdo viti akademik publikon në faqen zyrtare të tij, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore.</p> <p>Institucioni nëpërmjet NjSBC-së përdor metoda të drejtpërdrejta/ të tërthorta vlerësimi.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit) Fokus grupe (në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj.</li> </ul> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Bëhet vlerësimi me nota dhe pikë;</li> <li>Hartohen teste paraprake dhe përfundimtare;</li> </ul>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Institucioni përfshin gjithmonë të dhënat e raporteve semestrale siç janë % e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ndjek procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në çdo fund semestri.</p> <p>Programet e studimeve dhe syllabuset rishikohen çdo fillim viti akademik, me pjesëmarrjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë.</p> <p>Synohet përditësimi me ndryshimet në përputhje me kërkesat e tregut. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Mësimin dhe Kurrikulat.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni për sigurimin e cilësisë, ka ngritur strukturat përkatëse deri në nivel njësie bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të duhur, gjithmonë në përputhje me Manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”</p> <p>Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Sistemi i sigurimit të cilësisë se programit në fjalë, garantohej, përpos të tjerave dhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo zyrë siguron drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. Institucioni ndjek procedurën e vlerësimit periodik për programin, ku fokus bëhet dhe përditësimi i syllabuseve nëse del nga vlerësimi i studenteve, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në çdo fund semestri. Në fillim të çdo viti akademik sqaron studentët dhe stafi akademik mbi rëndësinë e vlerësimit periodik të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit.</p>	

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Masteri i Shkencave në Psikologji Klinike u adresohet të diplomuarve që zotërojnë diplomën “Bachelor” duke ofruar njohuri të thelluara, teorie dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional në aftësi dhe rolet e intervistuesit klinik, këshillim psikologjik në grup, supervizim, këshillim familjar dhe në çift, teoritë e avancuara të këshillimit psikologjik, etj.

Programi përmban një total prej 14 modulesh, si dhe punë kërkimore individuale, e cila konkretizohet me një punim final kërkimor të studentëve (Temë Diplome). Programi funksionon në dy vite studimi. Programi i studimit përmban 13 ECTS në kategorinë e disiplinave të formimit të përgjithshëm (Bazë); 51 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese; 9 ECTS në kategorinë e disiplinave formuese të zgjedhura nga vetë studentët; 16 ECTS në kategorinë e disiplinave integruese dhe 35 ECTS për punimin e tezës së diplomës. **Në total programi ofrohet me 124 kredite.**

Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 5 kategori, nga A deri tek F. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A,B,C, janë lëndë të detyrueshme ndërsa lëndët e kategorisë D janë me zgjedhje. Gjatë vitit të dytë të studimeve, studenti përgatit temën e diplomës, mbrojtja e së cilës është kusht i domosdoshëm për diplomim. Nuk parashikohet praktikë profesionale në këtë program. Praktikant janë kryesisht lëndore. Sipas drejtueses së Departamentit, në këtë vit akademik, 2018-2019 do të ofrohet edhe praktika profesionale.



Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore. Në bibliotekë ka literaturë që e ndihmon studentin për realizimin e programit. Institucioni vendos në dispozicion të studentëve mjedise me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve, të cilat janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi  
Programi i studimit ka pranuar brezin e parë të studentëve në vitin akademik 2011-2012.
- Objektivat e programit të studimit dalin qartë. Ka interes nga institucioni për përgatitjen akademike dhe profesionale të studentëve deri në diplomim e tyre në Psikologji Klinike. Referuar disiplinave konstatohet që ka një pikëprerje të dijes së mirfilltë psikologjike dhe dijes klinike. Disiplinat shtrihen në të gjithë spektrin, disiplina bazë, integruese dhe karakterizuese. Fakti që programi ka një kohështrirje relativisht të gjatë nga viti 2011, ka mundësuar përmirësime të syllabuseve dhe të metodologjive përmes të cilave përmbushet programi. Gjatë viteve akademike që ofrohet ky program studimi janë bërë disa ndryshime në planin mësimor si në zëvendësim të lëndëve ashtu edhe në grupim të tyre në module. Sipas drejtuesve por edhe stafit akademik, këto ndryshime janë bërë për një përmirësim të mëtejshëm të këtij programi. Programi mundëson dhe aftësinë për të bërë kërkime në fushën e psikologjisë klinike, falë disiplinave që stimulojnë metodologjitë e kërkimit cilësor dhe sasior. Edhe sipas GVJ këto ndryshime janë cilësore.
- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
  - 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
  - 1 orë mësimore = 50'
- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë
- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
- Leksionet 525 orë në auditor dhe 850 orë punë e pavarur e studentit
  - Seminaret 300 orë në auditor dhe 550 orë punë e pavarur e studentit
  - Provimi përfundimtar 875 orë punë e pavarur e studentit

Sipas përgjegjësit të departamentit, Programi do të ofrohet së fundmi i përmirësuar dhe në kohështrirje. Nga 124 ETC janë parashikuar 120 ETC, duke përfshirë edhe praktikën profesionale. Ky proces ri-organizimi është përmbushur përmes procedurave të brendshme të institucionit dhe është konfirmuar nga MASR. Ndryshimet dhe përmirësimet kanë prekur dhe përgatitjen e diplomës në raport me praktikat profesionale në raportin 18/35 orë.

Përveç ndryshimeve të mësipërme, një numër lëndësh janë grupuar në module.

Respektivisht:

- 1. Lëndët "Vlerësim Psikologjik" dhe "Njohuri dhe aftësi të psikologut klinik" janë grupuar në modulën "Vlerësim Psikologjik dhe njohuri dhe aftësi të psikologut klinik".
- 2. Lëndët "Metodat cilësore të kërkimit shkencor" dhe "Metodat sasiorë të kërkimit shkencor" janë grupuar në modulën "Metodat cilësore dhe sasiorë të kërkimit shkencor".
- 3. Lëndët "Psikoterapi" dhe "Neuropsikologji Klinike" janë grupuar në modulën "Neuropsikologji Klinike dhe Psikoterapi".
- 4. Lëndët "Psikopatologji e Adoleshentëve" dhe "Psikopatologjia e zhvillimit të fëmijëve" janë grupuar në modulën "Psikopatologjia e Zhvillimit të Fëmijëve dhe adoleshentëve".

### **Vlerësimi për Syllabus**

Referuar RVB dhe vizitës në institucion rezultojnë se syllabuset nga pikëpamja e strukturës janë solide, janë të unifikuara. Syllabuset ndjekin skemën: qëllimi, objektivat, përmbajtje e disiplinës, shtrirja në kohë, vendodhja në currikul, sasia e orëve, shpërndarja leksion/seminar, metodologjitë e përmbushjes, deri tek literatura. Titulli i Profesorit që e përmbush...e tjer

- Emërtimi i lëndës/modulit - Po
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda - Po



- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën - Po
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit - Po
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës - Po
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë - Po
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik - Po
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS - Po
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre - Po
- Format e vlerësimit të studentëve - Po
- Detyrimet e studentit për lëndën - Po
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse - Po
- Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve janë të fokusuar në kompetencat që studentët do të përfitojnë përgjatë lëndës si dhe përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi lëndën.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 327, dt. 07.08.2012. Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek Programin e Studimit nuk është 60 kredite. Në total ky program ofrohet me 124 kredite.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të</p>	<p>Masteri i Shkencave në “Psikologji Klinike” mundëson studentët që kanë diplomën “Bachelor” Ky program studimi synon kërkimin shkencor dhe tenton për baza të qëndrueshme njohurish për të vazhduar me studimet e ciklit të tretë – doktoratës.</p> <p>Studentët që mbarojnë Programin e Studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” kanë të drejtë të aplikojnë pranë Urdhrit të Psikologut për t’u pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit. Ata mund të punojnë si psikologë klinikistë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ qendrat spitalore universitare,</li> <li>▪ agjenci publike/jopublike të shëndetit mendor,</li> <li>▪ qendra të rehabilitimit fizik dhe mendor,</li> <li>▪ qendra të këshillimit universitar,</li> <li>▪ institucione riedukimi,</li> <li>▪ gjykata dhe rajone policie.</li> </ul> <p>individualisht në sektorin privat (studio psikologjike)</p>



arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
<b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve:</p> <p>Provimi përfundimtar 60 pikë (60%); Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%); Pjesëmarrja aktive në seminar 10 pikë (10%); Ese/prezantim/punë në grup 10 pikë (10%)</p> <p>Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare, testim përgjatë semestrit, ese, etj.), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës.</p>
<b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislaionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi përmban (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diploma që jepet në përfundim.</p>
<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Gjatë takimeve në AU, GVJ ju komunikua se:</p> <p>Janë realizuar 4 Konferenca studentore në të cilat kanë referuar 18 studentë që studiojnë në programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Psikologjisë.</p> <p>Stafi akademik angazhohet në punën kërkimore. Në përfundim të çdo vitit akademik, personeli akademik i përfshirë në këtë program, dorëzon formularin e plotësuar të veprimtarisë kërkimore shkencore të realizuar gjatë vitit. Gjetjet e punimeve kërkimore prezantohen gjatë orëve të lektrimit, si mbështetje e qasjeve teorike.</p>
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Egziston një analiza e tregut të punës bazuar në nevojat e njerëzve dhe mundësitë e punësimit në vitin 2016. Por, ky studim na rezulton të jetë empiric, më shumë sesa i ndërtuar mbi instrumente studimi real.</p>
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi nuk bie ndesh me interesat kombëtare</p> <p>Interesat kombëtare garantohej nëpërmjet formimit të profesionistëve të cilët do të kujdesen për mirëqenien psikologjike dhe shëndetin mendor të qytetarëve.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p><b>Deri në vitin akademik 2017-2018 programi i Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike realizohej me 124 ECTS, 35 prej të cilave përfitohen për projektin kërkimor të realizuar në kuadër të tezës së diplomës.</b></p> <p><b>Me ndryshimet e reja të bëra nga Institucioni, ky program do të ofrohet me 120 kredite prej të cilave 35 për diplomën</b></p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe sylabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe sylabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Nga kontakti i planifikuar me studentët e këtij programi, na rezultojnë që, programi, sylabuset, kopetencat profesionale që pritet të përmbushen në këtë program, janë të qarta. Biseda me studentët, e konsolidoi besimin se programi ka pikë të fortë të qënës të qartë. Sipas studeneteve, kontakti me stafin akademik dhe mundësia për informacion është lehtësisht i aksesueshem, si në faqesite dhe në mënyra të tjera.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Plani i programit, e shpjegon shtrirjen në kohë, procedimin përgjatë çdo disipline, deri në fazën e përgatitjes së diplomës dhe identifikimin e tezës, pedagogut që do ta udhëheqë. Në program del qartë që: për të përmbushur tezën, vihen në dispozicion 35 kredite për çdo student.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p><b>Deri në vitin 2017</b> programi i Studimit Master i Shkencave në "Psikologji Klinike" realizohej me 124 ECTS, 35 prej të cilave përfitohen për projektin kërkimor të realizuar në kuadër të tezës së diplomës. Me përmirësimet e bëra brenda institucionit dhe me miratim të MASR, ky program është 120 kredite prej të cilave 35 ECTS shkojnë për diplomën Nga kontakti i planifikuar me studentët e këtij programi përgjatë vizitës, na rezultojnë që, programi, sylabuset, kopetencat profesionale që pritet të përmbushen në këtë program, janë të qarta.</p>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mbështetur në RVB, GVJ shprehet se: Mësimdhënia në Albanian University realizohet në bazë të vitit akademik, data e fillimit të të cilit shpallet nga Ministri i Arsimit, dhe ndahet në dy semestra. Një semestër ka përkatësisht 15 javë mësimi, ku secila javë ka 20-25 orë mësimore.

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat, detyrat e kursit, provimet e mesit të semestrit, provimet e kursit, temat e diplomave, projekte, etj., të organizuara në module. Numri total i veprimtarive formuese është 15, ku janë parashikuar 14 provime dhe teza e diplomës.

Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndë janë semestrale ose vjetore.



Leksionet zhvillohen në bazë kursi; ushtrimet dhe seminarët zhvillohen në bazë grupi mësimor. Dija e studentit kontrollohet në çdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin në formën e bashkëbisedimit, nëpërmjet zhvillimit të testeve ose seancave të kontrollit të dijes.

Në vlerësimin e dijes së studentit pedagogu, mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, ushtrime, punime të ndryshme dhe detyra kursi. Kontrolli i dijes bëhet me shkrim, me detyra kursi dhe me gojë. Përgjithësisht, vlerësimet me shkrim vlejné për punimet individuale dhe provimet, ndërsa ato me gojë realizohen përgjatë seancave mësimore.

Vlerësimi i tezës së provimit përfundimtar është pjesë e vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare, testim përgjatë semestrit, ese etj.), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës.

Vlerësimi bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me germa nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

- Leksione
- Seminare
- Praktikë lëndore

Format e kontrollit të njohurive

Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të disa eelementëve si pjesëmarrja aktive, detyrat e kursit, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët përfshihen në aktivitetet shkencore që realizon fakulteti, por edhe në aktivitetet të tjera që organizohen jashtë IAL.

## **9. Studentët**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Sipas RVB, për të ndjekur programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji klinike studentit duhet të ketë përfutur një diplomë të ciklit të parë të studimeve ku ka grumbulluar 180 ECTS dhe në rastin e diplomave të fituara jashtë shtetit je jetë e ekuivalentuar nga MASR; studentit gjithashtu duhet të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë.

Në rast se studentit ka përfutur një diplomë tjetër jashtë disiplinës së përcaktuar më lart atëherë një komision i veçantë i ngritur nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore vlerëson aplikimin duke patur në konsideratë këto kriteret:

- Diploma e ciklit të parë të jetë e përputhshme në masën 60% me programin e studimit të Masterit të Shkencave në Psikologji Klinike
- Dosjen e kandidatit
- Motivimin e tij për të ndjekur programin e studimit të kërkuar

Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit në Psikologji Klinike është 2 vite akademike (katër semestra). Afati maksimal i përfutimit të studimeve të plota është 4 vite akademike (dyfishi i afatit të rregullt) pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studentit i ka pezulluar studimet. Studentit mund të vijojë



pjesëmarrjen në programet e mesipërme në Universitet mbi kohën e rregullt të studimeve, kur shlyen detyrimet sipas planit mësimor dhe paguan tarifën përkatëse.

Studenti lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës. Lëndët të cilave u përkasin kreditet e mbetura konsiderohen detyrime të mbartura. Kushtet dhe rendin e shlyerjes së detyrimeve të mbartura për fitimin e krediteve të mbetura i cakton Departamenti, në zbatim të rregullores së Fakultetit.

Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde. Kur studenti ka frekuentuar më pak se 50% të seancave të parashikuara në kurrikul, humbet të drejtën të shlyejë provimin përkatës jo vetëm në sesionin e rregullt të provimeve, por edhe në sesionet e ripërsëritjes. Ai është i detyruar që ta rifrekuentojë lëndën përkatëse

Informimi i studentëve në lidhje me programet e studimit dhe kurrikulat realizohet që në momentin e parë të kontaktit të tyre me stafin akademik dhe administrativ të AU, kur ata interesohen rreth mundësive për ndjekjen e studimeve në Albanian University; gjatë javës së orientimit në fillim të çdo viti akademik, si dhe përmes njoftimeve të vazhdueshme që shpallen nga Sekretaria dhe përmes faqes së internetit të AU. Në fillim të çdo viti akademik studentët pajisen me një dosje, e cila përmban informacion të hollësishëm mbi planin kalendarik të programit të studimit, orarin mësimor, plan programet e lëndëve që do të zhvillohen, aktivitetet vjetore të parashikuara, listën e literaturës së detyrueshme dhe këshillueshme. Stafi mbështetës i departamentit ofron në mënyrë të vazhdueshme informacion të përditësuar mbi ecurinë e programit të studimit dhe procedurat e akreditimit.

Të gjithë studentët të cilët përfundojnë studimet e tyre në programin Master i Shkencave në "Psikologji Klinike" janë Alumni i tij. Zyra e Karrierës dhe Alumnit kujdeset në mënyrë periodike për krijimin e një database statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në "Albanian University";

Në total, përgjatë periudhës 2011-2018 janë diplomuar 195 studentë, prej të cilëve 73 janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 42 janë punësuar jo në përputhje me diplomën.

#### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Studentët e pranuar në këtë program duhet të plotësojnë disa kritere, të cilat janë të paraqitura edhe në RVB por edhe Ju komunikuan GVJ si:

1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor ku ka grumbulluar 180 kredite ECTS dhe në rastin e diplomave të fituara jashtë shtetit të jetë e ekuivalentuar nga MASR.
2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë.
3. Të paguajë tarifën e caktuar vjetore.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Studentët e këtij programi kanë diplomë Bachelor në Psikologji të përgjithëshme. Por ka edhe student me formim më të thelluar se Bachelor. Studentët me të cilët kontaktua ishin të punësuar në institucione të cilat e mundësojnë zhvillimin e dijes në fushën e psikologjisë klinike. Studimet i ndiqnin në fundjava dhe referuar përvojave të secilit, studentët "provokojnë" dijen klinike psikologjike nga materia që ata sjellin nga institucioni ku punojnë në institucionin ku thellojnë të përditshmen e tyre, universitare.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

Në vitin akademik 2012 – 2013 numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi ka qenë 25, mesatarja e tyre hyrëse ka qenë 7.1. Në vitin e dytë të këtij programi vazhduan studimet e tyre dhe u diplomuan 25 studentë dhe mesatarja e tyre në dalje ishte 7.14.

Për vitin akademik 2013- 2014, u regjistruan 27 studentë dhe në vitin e parë është shtuar 1 student i transferuar. Mesatarja e tyre hyrëse ka qenë 7.74. Këtë program e përfunduan me sukses 28 studentë, me mesatare 8.12.

Në vitin akademik 2014-2015 në këtë program studimi u regjistruan për herë të parë 17 studentë, me mesatare hyrëse 7.15 dhe 8 studentë të regjistruar në vitin e dytë me transferim. Në fund të vitit të dytë të këtij programi u diplomuan 25 studentë dhe mesatarja në dalje ishte 7.96.



Në vitin akademik 2015-2016 u regjistruan 38 studentë dhe mesatarja e tyre hyrëse ishte 7.52 dhe në fund u diplomuan 38 studentë me notë mesatare 8.42.

Në vitin akademik 2016-2017 për herë të parë u regjistruan në këtë program studimi 24 studentë dhe mesatarja e tyre në hyrje ishte 7.9. Në vitin e parë një student u regjistrua për herë të parë si program i dytë studimi dhe në vitin e dytë 6 studentë janë regjistruar me transferim. Në përfundim, u diplomuan 31 studentë dhe mesatarja e tyre ishte 8.47.

Sipas të dhënave të marra nga Sekretaria mësimore, studentë aktivë në vitin e parë akademik 2017-2018 janë 26 studentë, nga të cilët 23 studentë janë rregjistruar për herë të parë në vitin e parë, 1 student është transferuar në vitin e parë dhe 1 studentë është rregjistruar në vitin e parë si program i dytë studimi. Në këtë vit ka konfirmuar stazhin një student në vit të parë. Gjithsej në total janë 26 studentë. Studentë aktivë në vitin e dytë akademik 2017-2018 janë 28 studentë pasi në vitin e dytë 3 studentë janë rregjistruar dhe 2 studentë kanë ngel në stazh në vitin e parë. Numri i studentëve në total që ndjekin këtë program studimi është 54 studentë.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare Në vitin akademik 2017-2018 u diplomuan 31 studentë dhe mesatarja e tyre ishte 8.47.
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
1. Në vitin 2011 janë regjistruar 48 studentë për herë të parë në vit të parë.
  2. Në vitin 2012 janë regjistruar 25 studentë për herë të parë në vit të parë.
  3. Në vitin 2013 janë regjistruar 28 studentë gjithsej nga të cilët 27 janë regjistruar për herë të parë në vit të parë dhe 1 studentë i regjistruar me transferim në vit të parë.
  4. Në vitin 2014 janë regjistruar 25 studentë gjithsej nga të cilët 17 studentë janë regjistruar për herë të parë në vit të parë dhe 8 studentë të regjistruar me transferim në vit të dytë.
  5. Në vitin 2015 janë regjistruar 38 studentë gjithsej në vit të parë për herë të parë.
  6. Në vitin 2016 janë regjistruar 31 studentë gjithsej nga të cilët 24 studentë janë regjistruar për herë të parë në vit të parë, 6 studentë janë regjistruar me transferim në vit të dytë dhe \*1 student i regjistruar në vit të parë si program i dytë studimi.
  7. Në vitin 2017 janë regjistruar 30 studentë gjithsej nga të cilët 23 studentë janë regjistruar për herë të parë në vit të parë, 6 studentë janë regjistruar me transferim ku 1 studentë është regjistruar në vit të parë dhe 5 studentë janë regjistruar në vit të dytë dhe \*1 studentë është regjistruar në vit të parë si program i dytë studimi.

Të dhënat e mësipërme janë marrë nga RVB na përkojnë me të dhënat e marra gjatë vizitës së GVJ në Sekretarinë mësimore. Numri i studentëve në vitin akademik 2016-2017 rezulton si të regjistruar për herë të parë në vitin e parë 24 studentë dhe në total studentë që e frekuentojnë këtë program janë 28 studentë, ndërsa të regjistruar për herë të parë në vitin e parë 2017-2018 janë 23 studentë dhe në total studentë aktivë që e frekuentojnë këtë program janë 26 studentë

Të dhëna për punësimin e studentëve  
Numri total i studentëve të punësuar është 115.

Numri total të diplomuarve  
Në total janë diplomuar 195 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)  
Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 73.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)  
Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën është 42.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
Dokumentacioni i ammarë gjatë vizitës nga sekretari mësimore është në sistem dhe këtij dokumentacioni i është referuar GVJ për numrin e studentëve aktive në këtë program studimi.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	



<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët e këtij program kanë bachelor në psikologji. Por ka edhe student me formim më të thelluar se bachelor.</p> <p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi Në Master i Shkencave në Psikologji Klinike mund të regjistrohen studentët që zotërojnë Bachelor ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të.</p> <p>Studentët kandidatë duhet të paraqesin edhe dëshmi të marrjes së njëres prej 5 gjuhëve të huaja sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të çertifikuar në nivelin ndërkombëtar, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MASR dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Institucioni përpunon mbi politikat e pranimit të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit, duke i reflektuar ato në Rregulloren e Masterit të shkencave</p>
---	--

**Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.**

<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të programeve të studimeve nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>Në javën e parë të studimeve studentët informohen për programin, proceset e akreditimit dhe vlefshmërinë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>AU ka përgatitur dhe vendos në dispozicion të studentëve “Udhëzuesin për Zhvillimin e Karrierës.</p>
---	---

**Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni, ka diplomuar gjashtë breza ne Msc. “Psikologji Klinike”, numri total i të diplomuarve është 256.</p> <p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Të dhënat janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, në Regjistrimin e Diplomave. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik. Të dhënat statistikore i raportohen MASR dhe rektoratit.</p>
---	--

**Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.**



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Zyra e Zhvillimit dhe Karrierës ka një bazë të dhënash të përditësuar mbi punësimin e të diplomuarve ndër vite.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit kujdeset në mënyrë periodike për krijimin e një database statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në “Albanian University”.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Stafi mbështetës i departamentit ofron informacion të përditësuar mbi ecurinë e programit të studimit dhe procedurat e akreditimit.</p> <p>Informimi i studenteve në lidhje me programet e studimit dhe kurrikulat realizohet në momentin e parë të kontaktit të tyre me stafin akademik dhe administrativ, kur ata interesohen rreth mundësive për ndjekjen e studimeve në Albanian University; gjatë javës së orientimit në fillim të çdo viti akademik; si dhe përmes njoftimeve të vazhdueshme që shpallen nga Sekretaria dhe përmes faqes së internetit të AU dhe përgjegjësit e moduleve.</p>
<p><b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së përgjithshme ofron dhe shërbimin psikologjik, këshillim psikologjik, mbështetje psikologjike.</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët është përgjegjëse për krijimin e programit të mentorimit për studentët dhe <u>prirët</u> ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Studentët kandidatë duhet të paraqesin edhe dëshmi të marrjes së njërës prej 5 gjuhëve të huaja sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të çertifikuar në nivelin ndërkombëtar, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MASR dhe akteve nënligjore në fuqi. Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve. Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësi, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

GVJ gjatë vizitës në AU, pati takim edhe me Zyrën e Koordinimit dhe Kërkimit Shkencor. Sipas Drejtueses së kësaj zyre, pritoritet i Institucionit në tërësi është formimi i stafit akademik. Konferencat studentore organizoheshin nga Departamenti. Në lidhje me këtë program studimi, kjo zyrë kishte organizuar disa takime dhe konferenca në bashkëpunim me UBT, Kolegjin S&P Qiriaz. Mbështetur në RVB: Veprimtaria kërkimore – shkencore e AU prirët, organizohet e zhvillohet në zbatim të Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Tregues të veprimtarisë kërkimore janë konferencat shkencore, botimet në revista, kërkimet në bashkëpunim me institute apo agjenci kërkimore brenda dhe jashtë vendit nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Temat e diplomave të realizuara nga studentët e programit të studimit si kusht thelbësor për diplomimin e tyre, janë të realizuara në përputhje me



metodologjinë dhe metodat kërkimore të shkencës së psikologjisë dhe vlerësimi i tyre bazohet, në masë të konsiderueshme mbi kritere metodologjike.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor

GVJ Ju komunikua se AU ka realizuar disa takime/aktivitete/seminare të karakterit kërkimor shkencor në funksion të ngritjes profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studmi. Më konkretisht:

Në muajin Tetor (12-13 Tetor) 2013 u organizua seminari me temën “Terapia geshtatliste me fëmijët dhe adoleshentët”, me pjesëmarrjen e psikoterapistes Dr. Daniela Coco. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë në Albanian University Tiranë , Qendra e trajnimit në psikoterapinë e integruar dhe Albanian Gestalt Institute. Në muajin Nëntor (13 -14 Nëntor) 2013, Departamenti i Psikologjisë dhe Qendra Aksion Plus organizuan seminarin shkencor me temë “Cannabis dhe konteksti shumëdimensional i trajtimit të tij”.

Një tjetër aktivitet shkencor është organizuar në muajin Dhjetor 2013 me temë “Meditimi Transcendental”. Ky seminar shkencor është organizuar nga Organizata Kombëtare e Meditimit Transcendental dhe Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Albanian University.

Në Janar 2014 të 2014 është organizuar simpoziumi shkencor me temë “Psikopatologjitë e zhvillimit tek fëmijët dhe adoleshentët, çështje të evidentimit, diagnostikimit dhe të ndërhyrjes afatgjatë” organizuar nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, organizatës ndërkombëtare “Save the Children” dhe departamentit të Punës Sociale të Universitetit të Tiranës.

Në muajin Mars 2014 Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Albanian University, Pink Embassy dhe Përfaqësues nga CRCA kanë realizuar simpoziumin me temë “Njohje me komunitetin LGBT, aktiviteti i pink Embassy dhe rast bullizmi në këtë komunitet”.

Në Prill 2014 Instituti Alfred Adler, Tiranë në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme kanë organizuar për studentët e nivelit master, seminarin shkencor me temë: “Psikologu klinik dhe psikoterapisti: sfidat e një të ardhmeje të afërt”.

Një tjetër aktivitet i organizuar nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative në bashkëpunim me Qendrën Filozofike-Kulturorë “Akropoli i Ri”, në kuadër të tematikave shkencore me temë , “Polaritetet e personalitetit mashkull-femër”.

Në muajin Maj 2014, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Psikodramës organizuan seminarin me temë “Psikodrama në Psikoterapi”. Në 29 Maj 2018 u mbajt Konferenca Studentore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore me temë: «Sistemi i Drejtësisë në Shqipëri, Ndarja dhe Kontrolli reciprok i pushteteve», ku referues ishin vetë studentët.

Në muajin Qershor 2014, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme organizoi në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Tetovës, Universitetin e Shkodrës dhe Institutin e Sociologjisë së Shqipërisë, Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Tranzicioni dhe Shoqëria, një qasje multidisiplinare”. Në këtë konferencë u kumtuan shumë studime shkencore dhe studentëve dhe të pranishmëve të tjerë iu mundësua njohja me të rejtat më të rëndësishme nga disiplina shkencore e psikologjisë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik publikon artikuj në revista apo buletine shkencore jashtë dhe brenda vendit.  Revistat janë me bord shkencor, çka do të thotë që kalojnë në një proces vlerësimi shkencor. Disa nga pedagogët janë aktivë. Lidhur me botimet e librave, nga ajo që u vu re ka disa libra që nuk përmbushnin standartet për të qenë libra akademikë. Sepse pjesë të referencave nuk reflektoheshin në tekst, dhe shkrimi i gjuhës shqipe është me gabime të shumta.



<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Personeli akademik nuk angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj pasi Institucioni nuk ofron programe në gjuhë të huaj. Megjithatë nga verifikimi i dosjeve të stafit në zyrën e burimeve njerëzore pamë se ata kishin dëshmi të zotërimit të gjuhës së huaj. IAL AU nuk ofron mësimdhënie në gjuhë të huaj.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Institucioni nuk ofron programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor.  <i>I rekomandojmë/sugjerojmë institucionit të ketë fonde për specializime të mëtejshme të stafit akademik për fusha specifike si psh instrumentat të testimi dhe vlerësimi për pacientë. Trajnime për çrregullime të ndryshme tek fëmijët, të rriturit, familjet apo grupet.</i>  Institucioni ofron mundësi për kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit që duhet te përmirësohet akoma. <b>Rekomandohet që përveç lejeve që jepen të mundësohet dhe pagesa e fee-ve të caktuara për konferenca dhe trajnime.</b>
<b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Departamenti disponon të dhëna mbi botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik. Në këtë program studimi nuk ka projektet kërkimore shkencore ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. Personeli akademik është i angazhuar kryesisht në projekte kombëtare  Baza e të dhënave rifreskohet çdo vit akademik.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
Personeli akademik nuk angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj pasi Institucioni nuk ofron programe në gjuhë të huaj.  GVJ konstatoi se mbështetja financiare për zhvillimin profesional të stafit është minimaliste. Mbështetja që AU ju ofron pedagogëve si në botimet në revistën shkencore Optime, ashtu edhe në tarifata e reduktuara në prezantimin e kërkimeve shkencore në konferencat e zhvilluara nga Institucioni, janë detyrime të paevitueshme që Institucioni duhet ti ofrojë stafit. <u>Sugjerohen të investohet strategjikisht për kualifikimin e mëtejshëm të pedagogëve efektivë dhe të mundësojnë kontrata afatgjata me staf me profile të spikatur në fushën e Psikologjise Klinike. Të stimulohen prurjet e studentëve të huaj që të jenë pjesë e këtij programi.</u>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Piesa përshkrimore





**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

AU ka nënshkruar marrëveshje të shumta me IAL-të brenda dhe jashtë vendit, institucione vendore, organizata profesionale, OJF etj. Në kuadër të këtij bashkëpunimi mund të përmendim marrëveshjet e nënshkruara me Universitetin e Tiranës, Universitetin "Fan Noli", Universitetin "Luigj Gurakuqi", Universitetin "Aleksandër Moisiu", Bashkia e Tiranës, Qendra ARSIS, Qendra Sociale "Te qëndrojmë së Bashku" etj. Por këto marrëveshje nuk funksionojnë vetëm për këtë program studimi por edhe për të gjitha programet e studimit të tjera. Bashkëpunimi me IAL- të tjera nuk garanton praktikat profesionale të studentëve. Ndërsa marrëveshjet institucionale me OJF apo bashkinë nuk janë mjaftueshëm për të gjithë studentët e programit.

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme disponon 11 marrëveshje për vitin akademik 2017-2018.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Stafi akademik është përfshirë në disa projekte kombëtare. Stafi akademik ka marrëdhënie pune me institucione të tjera profesionale, edhe institucioni ka disa marrëveshje pro që nuk mbulojnë praktikat profesionale të studentëve të këtij masteri.

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (ploteso Tabelat ne aneks)  
Për këtë program studimi vihet re se ka disa bashkëpunime ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor dhe një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (ploteso te dhenat ne aneks)

IAL ka disa marrëveshje bashkëpunimi dhe komunikim me institucione shtetërore (univeristet, spitale, etj), organizata profesionale (Qendra ARSIS, etj) dhe nga komuniteti i biznesit si shoqëri konsulente, zyrë noteri, etj.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese; <b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	Gjatë shqyrtimit të RVB por edhe në takimet e ndryshme, GVJ konstaton se: Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë aktivitetet ekstrakurrikulare të studentëve të programit.  Këto marrëveshje nuk janë në terma specifike me institucione specifike dhe në përmbushje të programit në fjalë. <b>Rekomandojmë të vendosin marrëveshje me institucione që garantojnë praktika profesionale të studentëve të këtij masteri.</b>  Këto marrëveshje duhet të mbulojnë dhe aspektin e praktikave profesionale të studentëve, referuar programit të rishikuar të studimit. Praktikrat e studentëve janë bazuar në kontaktet profesionale të studentëve dhe pedagogëve më shumë sesa institucionale.
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	



**Kriteri 1** Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;  
**Kriteri 2** Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

